



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1308/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPSHT “Gjyli Komerc” me seli në fshatin Koprivë, p.n Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.V., kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.1362/22 të datës 10.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit NPSHT “Gjyli Komerc” me seli në fshatin Koprivë, p.n Mitrovicë., e datës 21.09.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.1362/22 të datës 10.08.2023, **Vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Me Aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, NPSHT “Gjyli Komerc”, me numër unik identifikues të biznesit 811306978 me seli në Mitrovicë me çka ka kërkuar anulimin e vendimit përfundimtar me numër KA nr. 030/2019 të datës 29.03.2019 të nxjerr nga e paditura Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me kërkesë për kompensim të shpenzimeve të procedurës në shumë prej 150 € për përpilimin e padisë 51€ për taksë gjyqësore, 135€ për përfaqësim në çdo seancë, si të bazuar. Ndërsa, secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën në tërësi e kundërshton aktgjykimin e ankimuar për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit “Gjyli Komerc” me seli në fsh “Koprivë” Komuna e Mitrovicës si e bazuar, të prishet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Parë KA.nr.1362/22 i datës 10.08.2023 si i pa bazuar dhe jo ligjor ashtu që lënda ti kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

E Paditura, ka parashtruar përgjigje në ankesë me datë 03.10.2023, dhe pretendimet e paditësit në ankesë i konsideron si të pa bazuara, për shkak se ankesa nuk përmban kurrfarë arsytimi ligjor dhe arsytet e cekura janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara me dispozita ligjore andaj propozon që të refuzohet ankesa e paditësit dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1362/22 i datës 10.08.2023.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në drejtim të thënieve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës në kuptim të nenit 44, par. 1 dhe 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK), i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me aktvendimin K.A.nr.030/2019 të datës 26.03.2019 ka refuzuar ankesën me nr.1025 të datës 12.02.2019 të parashtruar nga ndërmarrja NPTSH “Gjyli Komerc” me pronar M.B., me nr. të Biz. 70274826 me adresë Koprivë-Komuna e Mitrovicës. Dhe ka lënë në fuqi vendimin nr.87 të datës 16.01.2019 në shumë prej 13,343.14€ për aktivitet ilegal pa posedim të Licencës së Shfrytëzimit në bazë të nenit 79 par 3, 4 dhe 5 të Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale.

Kundër këtij aktvendimi paditësi, ka hapur konflikt administrativ me padi në gjykatë. Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik dhe administrimit të provave relevante, si në procesverbalin e seancës për shqyrtim kryesor, në praninë e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me aktgjykimin e ankimuar me ankesë e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: gjykata vlerëson se Aktvendim nga Bordi i KPMM-së, me Nr. KA.030/2019 me datë 26.03.2019, më të cilin është refuzuar ankesa e parashtruar nga ndërmarrja N.P.T.SH. “Gjyli Komerc”, me pronar M.B., dhe është vërtetuar Aktvendimi me Nr. të protokollit 87 me datë 16.01.2019, me arsyetim se me datë 27.11.2018 Inspektorati i KPMM-së ka konstatuar se N.P.T.SH “Gjyli Komerc” në bashkëpunim me ndërmarrjen “Bageri -1” sh.p.k në lokacionin e vend shfrytëzimit minerare Koprivë, në regjionin e Komunës së Mitrovicës, kanë zhvilluar aktivitet të jashtëligjshëm minerar të shfrytëzimit të resurseve minerare të gurit të fortë në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin me nr. 04/L158 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 03/L-163. Me ç’rast inspektorët kanë konstatuar se ankuesi N.P.T.SH “Gjyli Komerc” aktivitetin e zhvillonte në koordinatat Y=748642; X=4745707; Z=601 pa poseduar licencë. Ndërsa makineria e angazhuar ishte Eskavator ngjyrë e verdhë, i ndërmarrjes N.P.T.SH “Gjyli Komerc”, Kamion Mercedes me targa 05-639-BE, Kamion Mercedes me targa 05-958-DL, Kamion Mercedes me targa 05-397-CE të ndërmarrjes “Bageri1” sh.p.k, është i ligjshëm dhe bazuar në konstatim të drejtë të gjendjes faktike. Ka shtuar se sipas nenit 319 të Ligjit për procedurën kontestimore, secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Paditësi pretendimet e cekura me larte nuk i ka vërtetuar

me asnjë prove. Fakti se në ekskavator ngjyrë e verdhë, ka qenë e vendosur logo e ndërmarrjes N.P.T.SH “Gjyli Komerc”, Urdhëresa për ndërprerje të aktivitetit të kundërligjshëm e datës 23.11.2018 i është drejtuar N.P.SH.T “Gjyli Komerc”, e cila nuk ishte kundërshtuar atëherë nga ndërmarrja, fakti se sipas Raportit të inspektimit të aktivitetit të jashtëligjshëm me Nr. ref. 004/KPMM A.B. në momentin e inspektimit është deklaruar si ekskavatorist në Ndërmarrjen N.P.SH.T, rezulton se personit A.B. si vozitës i ekskavatorit ishte punuar për ndërmarrjen N.P.T.SH “Gjyli Komerc”. Provat si fletën poseduese të pronës ku është zhvilluar aktiviteti, pëlqimi nga Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve e datës 28.12.2018, DUD-in, faturën 0408 për shitblerje të ekskavatorit nuk janë prova relevante me çka do të vërtetonin se paditësi ishte duke zhvilluar aktivitet të ligjshëm. Kjo ngase N.P.T.SH “Gjyli Komerc” aktivitetin e zhvillonte në koordinatat Y=748642; X=4745707; Z=601, ndërsa pëlqimi nga Drejtoria e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve ka të bëjë me parcelat 679-0 dhe 681-0. Deklarata A.B. dhe propozimi për dëgjimin e dëshmitarit A.B. dhe Xh.B. – vëllezër të paditësit si dhe pronarin e ndërmarrjes “Bageri 1” SH.P.K - Meriton Shabani, nuk janë prova të besueshme. Deklarata e personit A.B. është dhënë me datë 04.02.2019 pas Aktvendimit të KPMM-së me Nr. të protokollit 87 me datë 16.01.2019 me të cilin N.P.T.SH “Gjyli Komerc” i është shqiptuar gjoba. Ndërkaq që sipas Raportit të inspektimit të aktivitetit të jashtëligjshëm me Nr. ref. 004/KPMM theksohet se makineria e angazhuar ishte Ekskavatori ngjyrë e verdhë, i ndërmarrjes N.P.T.SH “Gjyli Komerc”, A.B. u deklarua si Ekskavatoristë në Ndërmarrjen N.P.SH.T “Gjyli Komerc”. Po ashtu sipas Urdhëresës për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm mineralar dhe sekuestrimin e mjeteve të punës dhe mineraleve me Nr. ref. 004/KPMM, me datë 23.11.2018 i drejtohet N.P.SH.T “Gjyli Komerc”, dhe urdhërohet të ndërpres aktivitetin e jashtëligjshëm mineralar. Kjo urdhëresë nuk ishte kundërshtuar nga N.P.SH.T “Gjyli Komerc”, dhe as nga A.B., që do të ishte me ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga KPMM. Deklarata e A.B. se ishte duke punuar me ekskavatorin e tij personal në pronën e tij është në kundërshtim me Dokumenti Unik Doganor me nr.0243295 dhe Faturën me nr.04/08 e datës 01.09.2008 e cila nuk është e evidentuar në emër të tij personal por në emër të blerësit Xh.B.. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 43 dhe 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë iu ka referuar Ligji Nr. 03/L-163, për Minierat dhe Mineralet i plotësuar dhe ndryshuar me Ligji Nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (LMM) Neni 2 përcakton fushëveprimin e ligjit për të gjitha aktivitetet që përfshijnë: *hulumtimin, shfrytëzimin dhe/ose pasurimin e lëndëve Minerale në Republikën e Kosovës; Resurset minerale, pavarësisht nga prejardhja e tyre, forma ose gjendja fizike, që gjenden në brendësi të tokës apo në sipërfaqe të saj dhe brenda territorit të Republikës së Kosovës, janë pronë e Republikës së Kosovës; Resurset minerale, të cilat nxirren nga një Bartës i Licencës për Shfrytëzim të lëshuar në përputhje me këtë ligj ose që është në fushëveprimin e nenit 85 të këtij ligji, kalojnë në pronësi të Bartësit të Licencës për Shfrytëzim në kohën e nxjerrjes dhe deponimit të tyre në sipërfaqe.* Në nenin 69 të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, përcaktohen se: autorizimet e Përgjithshme të Inspektorëve të Minierave për të inspektuar aktivitetet e hulumtimit, shfrytëzimit dhe aktivitetet e veçanta të cilitdo person, për të konstatuar: *nëse Personi i cili ushtron ato aktivitete posedon Licencë ose Leje të dhënë nga KPMM; nëse personi posedon Licencë ose Leje, për të konstatuar nëse aktivitetet janë duke u ushtruar në përputhje me Licencën ose Lejen përkatëse dhe rregulloret zbatuese të sigurisë dhe mjedisore të nxjerra nga Ministri në përputhje me këtë ligj.* Neni 69 i LMM-së, përcakton *nëse një person shfrytëzon ose eksploaton minerale në mënyrë të paligjshme, KPMM do ti shqiptojë këtij personi një gjobë që është e barabartë me trefishin e shumës së rentave minerare të cilat duhet të paguhen për mineralet e shfrytëzuara ose eksportuara.* Ndërsa, në nenin 70 paragrafi 3 i LMM-së përcaktohet: *nëse asnjëri nga këta persona ose punëdhënësi i tyre(nëse kanë punëdhënë) nuk posedojnë Licencë ose Leje nga KPMM, zyrtarët e policisë i arrestojnë Personat në fjalë të cilëve më pas u shqiptohet gjoba administrative e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 79 të këtij ligji dhe dënimet penale sipas Nenit 80 të këtij ligji. Përveç kësaj, inspektori*

konfiskon të gjitha mjetet punuese dhe mineralet e nxjerra që gjenden në vendin e rastit. Andaj, në bazë të raportit të inspektimit të aktivitetit të jashtëligjshëm me Nr. ref. 004/KPMM Inspektorati i KPMM-së ka konstatuar se N.P.T.SH “Gjyli Komerc” në bashkëpunim me ndërmarrjen “Bageri - 1” sh.p.k në lokacionin e vend shfrytëzimit minerare Koprivë, në regjionin e Komunës së Mitrovicës, kanë zhvilluar aktivitet të jashtëligjshëm minerar të shfrytëzimit të resurseve minerare të gurit të fortë speretinë në kundërshtim me Ligjin nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin me nr. 04/L-158 për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 03/L-163. Me ç ‘rast inspektorët kanë konstatuar se ankuesi N.P.T.SH “Gjyli Komerc” aktivitetin e zhvillonte në koordinatat Y=748642; X=4745707; Z=601 pa poseduar licencë. Sipas Urdhëresës për ndërprerjen e aktivitetit të jashtëligjshëm minerar dhe sekuestrimin e mjeteve të punës dhe mineraleve me Nr. ref. 004/KPMM, me datë 23.11.2018 N.P.SH.T “Gjyli Komerc”, urdhërohet të ndërpres aktivitetin e jashtëligjshëm minerar. Sipas Raportit për Operim ilegal i datës 09.01.2019 N.P.T.SH “Gjyli Komerc”, me numër të biznesit 70274826 me seli në Mitrovicë, fshati “Koprivë”, me pronar M.B., ngarkohet me gjoba administrative për shfrytëzim të gurit të fortë speretinë, në shumë prej 8,343.14 €.

Pretendimet ankimore se gjykata me rastin e administrimit të provave edhe pse i ka përshkruar një nga një kur vendos të njëjtat i injoron duke nxjerr në fund konkludim pa kurrfarë baze se eskavatori ka qenë i kompanisë “Gjyli Komerc” dhe se me të njëjtin ka punuar vëllai i pronarit të kësaj kompanie A.B.. Dhoma e Shkallës së Dytë konstaton së Dhoma e Shkallës së Parë me të drejtë ka konstatuar pasi që paditësi nuk ka dëshmuar me asnjë provë materiale se në mes të N.P.SH.T “Gjyli Komerc” dhe personit A.B. vozitës i ekskavatorit ngjyrë e verdhë, me llogo të ndërmarrjes N.P.T.SH “Gjyli Komerc”, ka pasur ndonjë marrëveshje kontraktuale për punë specifike dhe për një periudhë të caktuar kohore, e qe do ta përjashtonte përgjegjësinë e paditësit në rast se personi A.B. të përdorë logon e ndërmarrjes N.P.T.SH “Gjyli Komerc”, për tu angazhuar në aktivitetet të kundërligjshme. Dhoma e Shkallës së Parë përfundimin e tërë procedurës e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në refuzimin e padisë. Gjithashtu duhet pasur parasysh se gjobat e shqiptuara nga e paditura janë gjoba administrative të përcaktuara me dispozitat ligjore që rrjedhin nga Ligji për Miniera dhe Minerale.

Sa i përket pretendimit tjetër ankimor se gjykata ka bërë shkelje esenciale të dispozitave procedurale me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar nga shkaku se nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura nga ana e paditësit, nuk ka pranuar propozimin për dëgjimin e dëshmitarëve duke theksuar se dëshmitë e tyre edhe po të dëgjoheshin do të jenë prova të pa besuar, arsyetimin e aktgjykimit e bazon thjeshtë në provat dhe të dhënat të cilat i arsyeton e paditura. Këto pretendime ankimore kolegji i refuzon si të pa bazuara pasi që kolegji vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me procedurë të konfliktit administrativ ku trajtohet ligjshmëria e aktit Administrativ. Kështu, Dhoma e Shkallës së Parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Andaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, ngase paditësi me asnjë fakt të vetëm nuk e ka bërë të besueshëm se ankesa e tij është e bazuar. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1308/23, me datë 14.03.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri